




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-2762/12
Nr. l faq. Broj stranica	Data Datum 03.08.2012
Nr. pages 02	Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr.AKK-03-5089/11, për **z.Zejnel Morina, Drejtor i ” në Vushtrri**, për shkak se Zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dëshmuar se i ka përfunduar mandati si Drejtor i Spitalit në Vushtrri, dhe nuk ushtron më atë Funksion.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në lëndën e trajtuar me nr.AKK-03-5079/11, të dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit janë ndërmarrë veprimet e nevojshme të parapara sipas Ligjit Nr.04/L-051 dhe atyre procedurale sipas nenit 18.1 të po këtij ligji.

Pas zhvillimit të procedurës, dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se Zyrtari i lartë publik, ka qenë pronarë dhe person i autorizuar në një biznes privatë “ Ordinanca Pediatrike Premtim – Arti” që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051 paraqet konflikt të interesit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit i ka bërë shkresën e parë njoftuese më datë 02.03.2012 , dhe ka njoftuar z.Vedat Mulaku se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave zyrtari z.Vedat Mulaku me datën 19.03.2012 ka ardhur në Agjenci dhe ka sjellë Vendimin e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë me Nr.27/II/2012, të datës 23.02.2012 që dëshmon se i ka përfunduar marrëdhënia e punës me Ministrin e Shëndetësisë se Republikës së Kosovës dhe nuk është më në pozitën e Drejtorit të Spitalit “Sheik Zayed” në Vushtrri.

Konstatohet se pas ndryshimeve që janë bërë dhe gjendjes faktike tash, z.Vedat Mulaku nuk gjendet ne situatën e konfliktit të Interesit.

Andaj u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

